



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201800387/4

Tiranë ___/___/2018

Lënda : *Rekomandohet marrja e masave ligjore, për shpejtimin e gjykimit të çështjes gjyqësore civile me Nr.02900 akti datë 19.09.2017, të Gjykatës së Lartë Tiranë, që i përket shtetases E. G., nga qyteti i Shkodrës.*

Drejtuar : **Z.Rudin BAQLI**
Kancelar i Gjykatës së Lartë

TIRANË

I nderuar zoti Baqli,

Në ankesën e saj datë 19.02.2018, drejtuar Avokatit të Popullit, Zj.Erinda BALLANCA shtetësja E. G. nga qyteti i Shkodrës, ankohet për zvarritje të padrejta gjykimi, dhe shkelejen e procedurave gjyqësore nga Gjykata se Lartë Tiranë, në lidhje me mos planifikimin e shqyrtimit të rekursit të sa, kundra dy vendimeve gjyqësore, të shkallës së pare dhe të Apelit Shkodër.

Me vendiminn gjyqësor me Nr.1086 datë 08.07.2015 të Gjykatës Rrethit Gjyqësor Shkodër, është vendosur rrëzimi i kërkesë padisë.

Kundra këtij vendimi shtetësja E.G. është ankuar në Gjykatën e Apelit Shkodër e cila me vendimin e saj me Nr.157 datë 15.03.2017, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit me Nr.1086 datë 08.07.2015 të Gjykatës Rrethit Gjyqësor Shkodër.

Kundra këtyre dy vendimeve gjyqësore shtetësja E. G. ka ushtruar rekurs dhe ka kërkuar prishjen e tyre nga Gjykata e Lartë Tiranë, e cila akoma nuk ka planifikuar gjykimin e saj.

Rezulton se dosja gjyqësore e saj, tani ndodhet e regjistruar në Gjykatën e Lartë me Nr.02900 akti, datë 19.09.2017 dhe nga relatori nuk është planifikuar për gjykim akoma duke arsyetuar se në bazë të nenit 299/ pika 1 germa b të KPrC, afat i arsyeshëm për tu gjykuar çështja gjyqësore, në Gjykatën e Lartë konsiderohet afati 2 vjeçar.

Ankuesja E. G. nga qyteti i Shkodrës, nga ana e saj ankohet tek institucioni i Avokati i Popullit se Gjykata e Lartë Tiranë, ndaj saj po zhvillon një proces jo të rregullt ligjor, pasi ajo ka mbi 3 vjet i është drejtuar gjykatës dhe akoma nga ana e saj nuk ka marrë një vendim gjyqësor të formës së prerë dhe për këtë kërkohet nga Gjykata e Lartë që të veprohet sa më shpejtë, dhe sipas kërkesave të nenit 42 të Kushtetutës së RSH, ku përcaktohet se:

"Liria, prona dhe të drejtat e njohura me Kushtetutë dhe me ligj nuk mund të cënohen pa një proces të rregullt ligjor. Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive

dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjor, ose me rastin e akuzave të ngritura kundër tij ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një Gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj”.

Po kështu në nenin 28 të KPrC përcaktohet fare qartë se:

”Gjykata duhet të shprehet për të gjitha kërkesat që parashtrihen në padi, pa i kaluar kufijtë e saj, duke realizuar një gjykim të drejtë, të pavarur dhe të paanshëm brenda një afati të arsyeshëm”.

Shtetësja E. G. nga ana e saj, ka kërkuar ndihmën dhe ndërhyrjen e institucionit të Avokatit të Popullit, që ky rast të konsiderohet *rast i veçantë*, dhe të shikohet shpejtimi i saj sa më shpejtë me qëllim që asaj ti hapen rrugët për ndjekjen e këtij problemi si në Gjykatën Kushtetuese dhe në GjEDNJ.

Në këto kushte dhe duke u bazuar në kërkesat e nenit 63/3 të Kushtetutës së RSH, ku thuhet se: *”Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut, nga administrata publike”*, dhe në nenin 21/b të Ligjit me Nr.8454 datë 04.02.1999”Për Avokatin e Popullit”, ku parashikohet se:

”Pas përfundimit të hetimit, Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrjen e masave për vënien në vend të të drejtës së shkelur, tek organi epror i organit që ka shkatuar shkeljen, dhe për të gjitha këto arsye, ju

R E K O M A N D O J M Ë :

1.Marrjen e masave ligjore për shpejtimin e gjykimit të çështjes gjyqësore, me Nr.02900 akti, datë 19.09.2017, që i përket paditëses E. G. nga qyteti i Shkodrës.

2.Mbi masat e marra nga ana juaj, lutemi të njoftohemi me shkrim brenda afatit ligjor prej 30 ditësh.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

KOMISIONERI

Arben SHKËMBI